



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 528/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “W.Center” shpk, dhe “Shpiragu” shk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-73344-03-21-2017 me objekt: “*Blerje materiale pastrimi dhe shpërndarje në objektet shkollore dhe parashkollore*” me fond limit 10,833,265 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 22.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

**Ankimues:** “W.Center” shpk  
Rruga Dritan Hoxha, Pallati Teknoprojekt, Kati I Tiranë

“Shpiragu” shpk  
Bulevardi Zhan D’ark, nr.11/1 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.  
Rruga 5 Maji Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Operatori ekonomik W.Center shpk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa operatori ekonomik Shpiragu nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues W.Center shpk.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.03.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73344-03-21-2017 me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe sh[përndarje në objektet shkollore dhe parashkollore” me fond limit 10,833,265 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 22.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

II.2. Në datën 22.05.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 25.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Dimex	pa ofertë	I skualifikuar
- Murati D	1,571,050	I skualifikuar
- Euro Mega 2010	5,490,000	I skualifikuar
- Atlantik 3	6,792,400	I skualifikuar
- ORPC Albania	8,458,560	I skualifikuar
- Shpiragu	8,991,891	I skualifikuar
- Pastrime Silvio	9,678,900	I skualifikuar
- W.Center	10,286,050	I skualifikuar
- Alen Co	10,395,420	I skualifikuar

II.4. Në datën 25.05.2017 operatori ekonomik “W. Center” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Dokumentacioni i konfirmimit për përmbushjen e standarteve të CE për mallrat objekt prokurimi veçanërisht detergjentët është i paplotë, nuk është paraqitur në origjinal dhe i përkthyer por vetëm dokumentacion i thjeshtë i përkthyer. Produktet detergjentë do të përdoren në kopshte dhe çerdhe prandaj plotësimi i kësaj pike dhe garancia e këtij dokumentacioni është shumë i rëndësishëm për autoritetin kontraktor dhe nga vetë emërtimi i objektit të prokurimit.*

II.5. Në datën 01.06.2017 operatori ekonomik “W.Center” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Bazuar në dokumentat standarte të tenderit shtojca 8 kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3 kapaciteti teknik kërkohet në pikën 3: të gjitha mallrat sipas objektit të prokurimit duhet të përmbushin standartet europiane të konformitetit sipas normativae CE si vijon: EC Directive 91/155/EEC , EC Directive 1999/45/EC, ISO/IEC 17025:2005 ose ekuivalente të tyre. Shoqëria jonë pasi është njohur me arsyen e skualifikimit për arsye se nuk ka paraqitur dokumentat sipas normave CE origjinal ose të përkthyer dhe noterizuar ju bën me dije se ky dokument është i noterizuar tek noter Z Ilir Qejvani i cili është antar i Dhomës së Noterisë dhe përkthyer pranë përkthyeses Znj Eliona Qejvanaj e cila është përkthyes zyre e njohur nga MD dhe ka bërë përkthimin nga anglisht në shqip gjë të cilën e vërteton noteri në fjalë sipas ligjit. Ky dokument është i vlefshëm dhe i ligjshëm prandaj shoqëria jonë kërkon të rishqyrtohet edhe një herë ky vendim sepse është i padrejtë.*

II.6. Në datën 08.06.2017 me shkresën nr. 1085/4 prot, operatori ekonomik ankimues “W.Center sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 16.06.2017, pala ankimuese “W.Center” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 25.05.2017 operatori ekonomik “Shpiragu” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Mungon çertifikata ISO 14001:2004 ose ekuivalente e prodhuesit Gigant plast.*
- *2. Mungon çertifikata ISO 14001:2004 ose ekuivalente e prodhuesit Aricasa.*
- *3. Mungon çertifikata ISO 14001:2004 ose ekuivalente e prodhuesit Franz Mench GmbH.*
- *4. Mungon autorizimi i prodhuesit ose i distributorit zyrtar të Dalan Kimya Endustri për Shpiragu shpk.*
- *5. Çertifikatat e kompanive prodhuese janë leshuar nga kompanite çertifikuese: DNV, Intertek, TUV dhe SGS. Operatori ekonomik ka paraqitur akreditimet vetem per kompanite certifikuese DNV dhe SGS, te cilat nuk mund te verifikohen nese qendrojne apo jo pasi jane te pa perkthyer dhe pa noterizuara. Per kompanite Intertek dhe TUV nuk jane paraqitur dokumenta mbeshtetes.*
- *6. Shumica e produkteve të ofertuar nuk kanë katalog te perkthyer. Perkthimet e katalogeve jane bere nga OE dhe jo nga perkthyes i njohur zyrtarisht dhe nuk jane te vertetuara nga asnje noter sipas kërkesave ligjore të DST*
- *7. Oferta teknike nuk eshte plotesuar e sakte pasi per disa produkte pasi nuk perputhen kodet e produkteve me ato ne katalog dhe nuk perputhen emrat e katalogeve te deklaruar me kataloget e hedhur ne sistem.*
- *8. Autorizimi i prodhuesit Sutter Industries SPA për Shpiragu sh.p.k është i pa vulosur.*
- *9. Dokumentacioni i konfirmimit për përmbushjen e standarteve të CE për mallrat objekt prokurimi veçanërisht detergjentët është i paplotë, nuk është paraqitur në origjinal dhe i perkthyer por vetëm dokumentacion i thjeshtë i pa perkthyer. Produktet detergjentë do të përdoren në kopshte dhe çerdhe prandaj plotësimi i kësaj pike dhe garancia e këtij dokumentacioni është shumë i rëndësishëm për autoritetin kontraktor dhe nga vetë emërtimi i objektit të prokurimit*

II.9. Në datën 02.06.2017 operatori ekonomik “Shpiragu” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar arsyet e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Në datën 08.06.2017, me shkresën nr.1089/4 prot, operatori ekonomik “Shpiragu” shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.11. Në datën 20.06.2017, pala ankimuese, operatori ekonomik “Shpiragu” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Njëpërmjet shkresës me nr.1208/1 prot datë 28.06.2017 protokolluar me tonën me nr.1134/2 datë 29.06.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e opertaorit ekonomik ankimues “W.Center” shpk për kundërshimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Dokumentacioni i konfirmimit për përmbushjen e standarteve të CE për mallrat objekt prokurimi veçanërisht detergjentët është i paplotë, nuk është paraqitur në origjinal dhe i përkthyer por vetëm dokumentacion i thjeshtë i përkthyer. Produktet detergjentë do të përdoren në kopshte dhe çerdhe prandaj plotësimi i kësaj pike dhe garancia e këtij dokumentacioni është shumë i rëndësishëm për autoritetin kontraktor dhe nga vetë emërtimi i objektit të prokurimit*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pika 2.3. “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Te gjithë mallrat sipas objektit të prokurimit duhet te permbushin standartet Europiane te konformitetit sipas normativave CE si vijon; EC Directive 91/155/EEC, EC Directive 1999/45/EC, ISO/IEC 17025:2005 ose ekuivalentet e tyre.*

III.1.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet elementët e mallrave si më poshtë:

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>
1	<i>Acid per pastrim EC, te kete aftesi vepruese dhe pastruese te larta. Ambalazhimi ne shishe plastike jo me shume se 1 liter. Te permbaje HCL jo me pak se 30%. Gjendja fizike e lengut te jete leng i paster i bardhe, te kete aromen e freskise, ngjyra te jete blu ne jeshile. Vlera e PH jo me e madhe se 13 dhe jo me e vogel se 11.5. Klori aktiv te jete 50-55 gr/lt. Densiteti i lengut ne temperaturen 20°C te jete 1.070-1.080. Te jete i tretshem ne uje. Te jete ne</i>

	<i>perputhje me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.</i>
2	<b>Doreza gome</b> me numër 7-8-9. Të jenë rezistente për përdorim në larje muri e pllakash, elastike ne perdorim.
3	<b>Fshesa per pastrimin e merimangave</b> , te jete e perbere me qime te gjata mbi 10 cm. Koka te jete e montueshme dhe e cmontueshme me nje bisht te gjate perbere nga material metalik veshur me nje shtese plastike, dhe me mundesi zgjatje te bishtit. Fshesa dhe shkopi te kene mekanizmin e rrotullimit nga e djathta ne montim.
4	<b>Fshesa per pastrim te ambjenteve te brendshme</b> , te jete e perbere me qime te gjata mbi 10 cm dhe me qime te buta. Koka te jete e montueshme dhe e cmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta ne montim me shkopin. Pesha e saj te jete jo me e vogel se 340 gr.
5	<b>Bishta per fshesa dhe shtupa</b> duhet te jene prej metali dhe te veshura me plastike dhe gjatesi jo me te vogla se 100 cm me fileto.
6	<b>Fshesa per pastrimin e territoreve te jashtme</b> , e perbere nga qime melakuqi te dendura dhe te kapura forte me njera tjetren, me shkop druri te qendrueshme. Gjatesia e qimeve te fsheses te jete mbi 40 cm.
7	<b>Furça per pastrimin e EÇ</b> , te jete me qime te forta per pastrimin e siperfaqeve te veshtira. Furça te kete mbajtesen e saj (komplet). Pesha jo me shume se 300 gr.
8	<b>Kaci plehrash me bisht plastik</b> . Te jete ne forme kutie e hapur nga perpara per mbledhjen e papastertive te ndryshme, e pajisur me nje bisht te montueshem dhe çmontueshem. Ngjyra e kacise te jete blu, e kuqe ose jeshile. Te kete edhe fshese me bishte jo me te gjate se 45 cm.
9	<b>Aromatik per Ambjentin</b> , spray 400-750 ml ne shishe plastike. Gjendja fizike te jete leng, me arome lulesh, ngjyre ne te verdhe ose te bardhe. Vlera e PH jo me e madhe se 7.5 dhe jo me e vogel se 5.5. Densiteti i lengut ne temperaturen 20°C te jete jo me i madh se 0.885 +/- 0,005 g/ml. Te jete i tretshem ne uje. Te jete ne perputhje me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.
10	<b>Solucion lares enesh leng</b> , me efekt pastrimi te thelle. Ambllazhimi ne shishe 500ml- 1000 ml dhe me koke shisheje me mekanizem sprucimi te lengut. Gjendja fizike e lengut te jete leng i plote, te kete aromen limoni, ngjyre jeshile ose perberes me aloe vera. Te jete i tretshem ne uje. Produkti te jete konform me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.

11	<b>Dizinfektant cilesor per larjen e rrobave.</b> Ambalazhimi nga fabrika ne shishe plastike 1-2.5 litroshe. Perberja e lengut duhet te jete jo me pak se 4.2% klor aktiv ne formen e hypokloritit alkalin. Gjendja fizike te jete leng, me arome jo shume te forte, ngjyre ne te verdhe te zbehte. Vlera e PH jo me e madhe se 13 dhe jo me e vogel se 12.5. Te jete i tretshem ne uje. Te jete ne perputhje me direktiven EC Directive 1999/45/EC ose ekuivalentin e saj.
12	<b>Kosh plastik per hedhjen e mbeturinave,</b> te jete ne forme drejtevendore ose rrethore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtes i koshit te jete jo me i madh se 15 litra.
13	<b>Kosh plastik per hedhjen e mbeturinave,</b> te jete ne forme drejtevendore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtes i koshit te jete jo me i vogel se 10 litra.
14	<b>Kosh plastik i madh, te jete ne forme rrethore,</b> me kapak nga sipër që hapet plotesisht. Te kete dy doreza ne pjesen anesore me qellim transportimin e tij. Kapaciteti mbajtes i koshit te jete jo me i vogel se 100 kg.
15	<b>Kova larje me shtydhese komplet 10-15 lt me gjatesi 36 cm , gjeresi 26 cm dhe thellesi 27 cm.</b>
16	<b>Kova mbeturinash 50-70 lt.</b>
17	<b>Lecka per larje xhamash te jete 32x32 mikrofiber ideale per pastrim e perbere me 80% poliester dhe 20% poliammid.</b>
18	<b>Leter higjenike e paketuar me 10 rulon.</b> Te jete cilësore dhe e bute. Të ketë ambalazhimin e fabrikës me 8+2 rulona. Jo me shume se 2 shtresa.
19	<b>Qese mbeturinash 50x60cm te jete e paketuar 1 pako x10 fije dhe te jete me material te riciklueshem.</b>
20	<b>Qese mbeturinash per koshat e zyres 1x10 fije me permasa: gjatesi 50 cm, gjeresi 35 cm.</b>
21	<b>Qese per koshat 120 lt me permasa 70x110 cm, e cila eshte e forte dhe mbi te gjitha e riciklueshme.</b>
22	<b>Sapun rrobash 125 gr,</b> të jetë cilësor, me P-H e duhur, me aftësi larje të mirë. Produkti te jete konform me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.
23	<b>Sapun leng ne paketim 1-5 liter,</b> ambalazhimi nga fabrika ne shishe plastike me doreze ne pjesen e trupit te shishes per manovrim te produktit gjate punes. Gjendja fizike e lengut te jete leng, te kete aromen e luleve, ngjyra te jete e bardhe ose roze. Vlera e PH jo me e madhe se 6.5 dhe jo me e vogel se 5.5. Viskoziteti ne 20°C te jete jo me i vogel se 1000 cp dhe jo me i madh se 2000 cp. Densiteti i lengut ne temperaturen 20°C te jete jo me i madh se 1, 01 - 1, 1 gr/ml. Produkti te jete konform me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.

24	<i>Shtrydhese rezerve per kova larje.</i>
25	<i>Shtupe per larjen dysHEMEJE, e perbere nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofiber me dy kolore te buta qe thithin ujin shume mire. Dendesia e shtupes te jete jo me e vogel se 180 gr.</i>
26	<i>Sfungjer enesh (1 pako x 10 cope). Te jene te perdorshem per pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanash. Te jete ne ngjyre te verdhe dhe me pore te vogla ne perberjen e sfungjerit dhe me rrjete teli te bute per pastrim siperfaqesh te ashpra.</i>
27	<i>Aromatik per larje pllaka dysHEMEJE; Solucion larës dysHEMEJE cilësor, me fuqi larese te njollave, të jetë me aromë. Ambalazhimi ne shishe plastike 1 -5 litroshe. Gjendja fizike te jete leng, me arome lulesh, ngjyre vjollce. Vlera e PH jo me e madhe se 8.5 dhe jo me e vogel se 5.5. Te jete i tretshem ne uje. Produkti te jete konform me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.</i>
28	<i>Solucion lares xhamash, me efekt pastrimi te njollave dhe pluhurave ne xhama. Ambalazhimi ne shishe plastike jo me shume se 750 ml dhe me koke shisheje me mekanizem sprucimi. Gjendja fizike e lengut te jete leng i plote, te kete aromen limoni, ngjyre blu. Vlera e PH jo me e madhe se 8.5 dhe jo me e vogel se 5.5. Te jete i tretshem ne uje. Produkti te jete konform me direktiven EC Directive 91/155/ EEC ose ekuivalentin e saj.</i>



*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to*

**Shënim:** Furnizimi bëhet me mjetet e furnizuesit në çdo objekt parashkollor dhe shkollor sipas kërkesës të Autoritetit Kontraktor në sasi, lloj dhe kohë brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e nëbshkrimit të kontratës. Lloji dhe sasia e mallrave objekt prokurimi që do të shpërndahen do të përcaktohen qartë nga Autoritetit Kontraktor për çdo objekt shkollor dhe parashkollor në planin e shpërndarjes i cili do të vihet në dispozicion të operatorit ekonomik fitues ditën e nënshkrimit të kontratës.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstaohet se operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Direktivat e certifikimeve të prodhuesit Titiz në gjuhën angleze të përkthyer në gjyhën shqipe nga përkthyes të licensuar të njohur nga noteri, dhe noterizuara me përmbajtje si vijon: Ne Temzlik VE Kozmetik Urunleri Cleaning&Cosmetic Products me cilësinë e prodhuesve zyrtarë të produkteve të markës TITIZ informojmë se produktet e prodhuara prej nesh e kanë origjinën prodhuar në Turqi dhe të gjitha produktet tona janë në përputhje me direktivat : Direktivat e KE –së 91155/ EEC, Direktivat e KE-së 1999/45/EC dhe ISO/IEC 17025:2005. Të gjitha direktivat tona bazohen në Skedën e të Dhënave të Sigurisë së Materialeve (MSDS).



- Deklarata Konformiteti të lëshuara nga prodhuesi në përputhje me direktivën 91/155EEC të mallrave objekt prokurimi në gjuhën angleze të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licensuar të njohur nga noteri dhe të noterizuara.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese aftësia teknike: *b) operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Ligji Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë” i ndryshuar neni 39 parashikon shprehimisht se: *Noteri ka këto kompetenca: a) redakton aktet noteriale; b) bën njoftimin e kujtesje noteriale ose të akteve të tjera jashtëgjyqësore; c) legalizon nënshkrimet e shtetasve të vëna në akte të ndryshme; ç) harton kundërshtimet e kambialeve dhe vërtetimin e mospagimit të çekut; d) vërteton datën e paraqitjes së dokumenteve në zyrën e noterisë; dh) vërteton qënien e një personi dhe qëndrimin e tij në një vend të caktuar; e) pranon për ruajtje dokumente të personave fizikë e juridikë në zyrën noteriale; ë) lëshon kopje, shkurtime e pjesë të akteve të depozituar në zyrën noteriale; f) vërteton se kopjet ose shkurtimet e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit; g) bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër; gj) redakton procesverbale e bën inventare, duke përshkruar gjendjen e sendeve, sipas kërkesës së shtetasve dhe kur ngarkohen nga gjykata; h) redakton deklaratat e dokumente të kërkuara nga persona të interesuar, si dhe akte e veprime të tjera, që sipas ligjit duhet të bëhen nga noteri.*

Neni 40 parashikon se: *Aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike.*

Neni 65 parashikon se: *Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri dhe, kur ky nuk e di gjuhën e huaj, bëhet nga një përkthyes i njohur nga noteri sipas ligjit. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri sipas ligjit ose përkthyesi. Nënshkrimi i këtij të fundit vërtetohet nga noteri.*

Neni 56 parashikon se: *Noteri bën vërtetimin e njësisë së kopjeve ose të shkurtimeve të dokumenteve me origjinalin, pasi të ketë krahasuar përmbajtjen e tyre. Noteri duhet të*

*përmendë në vërtetim se nga kush është paraqitur dokumenti, nga i cili është nxjerrë kopja e shkurtimi, nëse këto janë nxjerrë nga një dokument origjinal apo nga ndonjë kopje tjetër, si dhe shënime nëse këto kanë pasur korrigjime, shtesa, fshirje a shenja të tjera të veçanta.*

III.1.6. Referuar arsyes së skualifikimit, bazës ligjore të sipërcituar si dhe dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni konstaton se Deklaratat e Konformitetit janë paraqitur nga ankimesi në gjuhë të huaj dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Dokumentat janë të përkthyer nga përkthyesi i licensuar firma e të cilit është njohur nga vetë noteri në përputhje me dispozitat ligjore sa më sipër ku shprehimisht parashikohet se “Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri dhe, kur ky nuk e di gjuhën e huaj, bëhet nga një përkthyes i njohur nga noteri sipas ligjit. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri sipas ligjit ose përkthyesi. Nënshkrimi i këtij të fundit vërtetohet nga noteri.

Në rastin konkret dokumentacioni i përkthyer në gjuhën shqipe është nënshkruar në fund të tij nga përkthyesi i licensuar dhe është shoqëruar me vërtetim përkthimi nga ana e noteres cka do të thotë që konfirmohet përkthimi i tyre nga organi që ligji i njeh shprehimisht të drejtën për përkthim e në këtë drejtim nuk rezulton asnjë mangësi dhe shkelje të ndonjë akti ligjor apo nënligjor në fuqi.

Akoma më tej deklaratat e konformitetit përmbajnë vulën e noteres në cdo fletë e cila ka kryer njehsimin me origjinalin të dokumentave të paraqitura nga ankimesi W.Center. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik nuk konstaton asnjë mangësi sa i takon vlefshmërisë së dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimes në këtë procedurë prokurimi dhe i gjen ato konform parashikimeve ligjore sa më sipër.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes *“W.Center”* shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes *“Shpiragu”* shpk për kundërshimin e skualifikimit të ofertës së tij Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në datën 21.03.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit *“Procedurë e Hapur”* me Nr. REF-73344-03-21-2017 me objekt: *“Blerje materiale pastrimi dhe sh[përndarje në objektet shkollore dhe parashkollore”* me fond limit 10,833,265

lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 22.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.

III.2.2. Në datën 22.05.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.2.3. Në datën 25.05.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.2.4. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues konstatohet se në datën 02.06.2017 operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.2.5. Në datën 08.06.2017, me shkresën nr.1089/4 prot datë 08.06.2017, operatori ekonomik ankimues Shpiragu shpk është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

III.2.6. Në datën 20.06.2017, operatori ekonomik ankimues “Shpiragu” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues “Shpiragu” shpk rezulton se ankesa e ankimuesit është pranuar nga autoriteti kontraktor në datë 02.06.2017 ndërkohë vlerësimi i ofertave në sistemin e prokurimeve elektronike është kryer nga autoriteti kontraktor më datë 25.05.2017. Autoriteti kontraktor në datën 08.06.2017, me shkresën nr.

1089/4 prot datë 08.06.2017, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur mospranimin e ankesës ndërsa ankesa në KPP është dorëzuar nga ankimuesi në datë 20.06.2017.

Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik “ të ndryshuar *strictu sensu* parashikohet se “ Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit më datë 25.05.2017.

Komsioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesën pranë autoritetit kontraktor jashtë afatit të parashikuar nga neni 63 pika 1 të L.P.P.-së pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor nis nga dita e nesërme e punës pasi ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret ankesa është paraqitur pranë autoritetit kontraktor në tejkallim të afateve ligjore më datë 02.06.2017. Gjithashtu edhe ankesa pranë KPP është dorëzuar jashë afatit 10 ditor që parashikon ligji referuar datës në të cilën autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mospranimin e ankesës.

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik Shpiragu shpk nuk ka respektuar afatet e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2.10. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj

të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### **Vendos**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “W.Center” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73344-03-21-2017 me objekt: “Blerje materiale pastrimi dhe shpërndarje në objektet shkollorë dhe parashkollorë” me fond limit 10,833,265 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 22.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë.
2. Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Shpiragu” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “W.Center” shpk dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “W.Center” shpk
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1115 Protokoli; Datë 01.06.2017**

**Nr.1134 Protokoli; Datë 02.06.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**